

Qerim DALIPI

**PERIUDHA E MESJETËS NË LIBRAT E HISTORISË TË ARSIMIT
TË MESËM NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË***

Hyrje

Përfshirja e ngjarjeve më të rëndësishme në përmbajtjet e programeve dhe të teksteve mësimore të historisë është obligim i atyre që hartojnë programet dhe i atyre që shkruajnë tekstet. Të parët dhe në veçanti të dytët duhet të mbajnë përgjegjësi profesionale dhe morale që tekstet të shkruhen në bazë të parimit të prezantimit të fakteve të pranuar në historiografi. Përkundër këtij parimi, në tekstet e historisë të arsimit të mesëm në Republikën e Maqedonisë, krahas aspekteve pozitiviste, mund të evidentohen një sërë lëshimesh domethënëse. Kjo situatë konsiderojmë se është edhe si rrjedhojë e së kaluarës, ku autorët, pasi që Maqedonia u bë shtet i pavarur, nuk mundën që të çlirohen tërësisht nga botëkuptime të caktuara në të shkruarin e teksteve të historisë. Rrjedhimisht, duke konsideruar se çështja e të shkruarit të teksteve në fjalë është një proces në vazhdimësi, e kemi parë të arsyeshme të analizojmë disa prej tyre, ku trajtohet periudha e mesjetës (shek. V-XV). Në këtë kuadër janë analizuar 3 tekste nga vitet e fundit të periudhës komuniste, 4 tekste pasi që Maqedonia u bë shtet i pavarur dhe 4 tekste të tjera që sot janë në përdorim. Gjatë analizimit të tyre, çështje të diskutueshme janë ballafaquar me të dhëna të literaturës relevante, dhe mbi këtë bazë janë dhënë argumente domethënëse, të cilat mund t'i bëjnë ballë kritikës shkencore.

Në aspektin metodologjik, përveç metodës së analizës, është përdorur edhe metoda e klasifikimit, me ç'rast janë klasifikuar librat e historisë sipas periudhave, si më sipër, ku trajtohet periudha e mesjetës.

Periodizimi i mesjetës

Ashtu si në të kaluarën edhe në ditët e sotme, periudha e mesjetës në librat e historisë së arsimit të mesëm, në Republikën e Maqedonisë, përgjithësisht përfshin periudhën kohore prej shek. V deri në shek. XVIII. Mesjeta, në fakt, periodizohet në këtë mënyrë: mesjeta e hershme (shek. V-XI), mesjeta e zhvilluar (shek. XI-XV), mesjeta e vonë (shek. XVI -XVIII). Në ndonjë rast, mesjeta e vonë konsiderohet njëkohësisht edhe si periudhë e fillimit të kohës së re, apo vetëm kohë e re.^{xi} Pavarësisht këtyre përkufizimeve, ne në punimin tonë do të kufizohemi në përmbajtjet mësimore që trajtojnë periudhën kohore të shekujve V-XV.

Sa i përket përfshirjes së periudhës së mesjetës në librat e historisë, si përpara, ashtu edhe nga koha kur Maqedonia u bë shtet i pavarur, varësisht nga drejtimet në arsimin e mesëm ose nga reformat arsimore që i janë bërë atij, ajo është e ndryshueshme. Kështu, mesjeta është përfshirë në librat e vitit I^{xi} dhe të II.^{xi}

Mesjeta në librat e viteve të fundit të periudhës komuniste

Mesjeta e hershme, në librin *“Historia për klasën I të shkollave të mesme (për gjimnaze)”*, botuar më 1978, është prezantuar me nëntëmbëdhjetë njësi mësimore. Prej tyre, tetë njësi janë nga historia e përgjithshme dhe njëmbëdhjetë nga historia e popujve jugosllavë. Në kuadër të kësaj të fundit, gjashtë njësi janë për Maqedoninë, tri për Rashën dhe Zetën, Kroacinë dhe sllovenët, kurse dy kanë të dhëna të përbashkëta për këto vende.^{xi} Nga historia e popullit shqiptar nuk ka asnjë njësi mësimore. Nga ana tjetër, njësitë mësimore, si njësi didaktiko-metodike, janë voluminoze, të ngarkuara me shumë ngjarje, emra vendesh e njerëzish etj. Kështu, p.sh. nga dy njësi të analizuar të këtij libri, del se njëra përbëhej prej rreth 110, kurse tjetra prej rreth 240 vargësh tekst të shkruar.^{xi} Përndryshe, njësitë mësimore deri diku janë të pajisura me ilustrime të qarta, madje në një pjesë të tyre janë dhënë sqarime përkatëse, të cilat, në fakt, sot nga autorët përdoren në kontekst *“nëse dëshiron të dish më tepër”*. Si zakonisht, në fund të çdo njësie mësimore ka pyetje dhe detyra.^{xi}

Në librin *“Historia për klasën II të shkollave të mesme (për gjimnaze)”*, botuar më 1978, mesjeta e zhvilluar është trajtuar në gjithsej njëzetekatër njësi mësimore. Në nëntë prej tyre është trajtuar historia e përgjithshme, kurse në njëmbëdhjetë të tjera historia e popujve jugosllavë. Për dallim nga libri për klasën e parë të shkollave të mesme, ku për historinë e Maqedonisë kishte njësi të veçanta, në këtë libër historia e Maqedonisë trajtohet në kuadër të njësive mësimore të popujve jugosllavë, në përputhje me rrethanat historike.^{xi} Ndërsa sa u përket njësive nga historia e popullit shqiptar, ato janë hartuar si njësi mësimore plotësuese për nxënësit shqiptarë në Republikën e Maqedonisë. Numri i tyre arrin në katër njësi mësimore, dhe dy nën njësi të tjera janë trajtuar në kuadër të dy njësive mësimore përkatëse. Sa u përket këtyre njësive e nën njësive të dedikuara për nxënësit shqiptarë, ato janë përmbajtjesore dhe dallohen për nga objektiviteti i paraqitjes së fakteve historike.^{xi} Marrë në tërësi, njësitë mësimore të këtij libri janë diç më të shkurtra, kurse për nga aparatura didaktike ato janë të ngjashme me ato të librit të vitit I.

Në vitin 1989, sipas një programi të ri, i formës së shkurtuar, u botua *“Historia për vitin I për të gjitha drejtimet, përveç drejtimit kulturologjiko-arsimor dhe administrativo-juridik”*. Në këtë tekst mësimor, periudha e mesjetës (shek. V-XV) prezantohet me gjithsej njëzet njësi mësimore, nga të cilat dhjetë kanë të bëjnë me historinë e përgjithshme, nëntë me historinë e popujve jugosllavë dhe një me historinë e popullit shqiptar. Në të vërtetë, historia e Maqedonisë është prezantuar në gjashtë raste në kuadër të njësive mësimore për popujt jugosllavë dhe në dy raste përmes njësish të veçanta mësimore.^{xi} Sa i përket njësisë mësimore për shqiptarët, në të midis të tjerave thuhet se shqiptarët e kishin origjinën prej asaj pjese të ilirëve që banonin në territorin e Shqipërisë së sotme,^{xi} duke mohuar kështu praninë e fiseve të tjera ilire në trevat e sotme të Republikës së Maqedonisë dhe të viseve të tjera në ish-Jugosllavi ku banonin shqiptarët. Në funksion të mbështetjes së qëndrimit tonë do të kishim përmendur faktin se prania e fiseve ilire në viset e sotme të Maqedonisë Perëndimore argumentohet edhe nga studiues objektivë *“maqedonas”*, midis të cilëve dallohet studiuesja V. B. Grozdanova.^{xi}

Për dallim nga librat e botuar më 1978, në tekstin e sipërpërmendur, botuar më 1989, që ndryshuar origjinaliteti i toponimeve, sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe, proces i përhapur në të gjitha sferat e jetës shoqërore e politike të vendit, si formë presioni ndaj “kombësisë” shqiptare në Republikën e Maqedonisë. Kjo ndodhte në një kohë kur kishte filluar mbyllja e shkollave të mesme me mësim në gjuhën shqipe (vitet 80 të shek. XX), respektivisht kur në emër të “bashkim-vëllazërimit” kishte filluar aplikimi i paraleleve të përziera, të përbëra nga nxënës maqedonas dhe shqiptarë, ku mësimi zhvillohej në gjuhën maqedonase. Kështu, në këtë tekst, në vend të formave shqipe u përdorën format sllave të toponimeve, si p.sh: *Skopje* për *Shkupin*, *Debar* për *Dibrën*, *Ohrin* për *Ohrin*, *Kiçevo* për *Kërçovën* etj.^{xi}

Njësitë mësimore të këtij libri janë diç më të shkurtra sesa ato të librave të botuar më 1978, dhe një pjesë e tyre shoqërohen me pjesë leximi “lexo për” ose “njoftohu me” që kryesisht janë materiale burimore, të dedikuara për nxënësit që dëshironin të fitonin më shumë njohuri dhe të kuptonin ngjarjet në mënyrë burimore. Po ashtu janë të rëndësishme edhe sqarimet e termeve të panjohura, në formë të fjalorthi, që janë dhënë në fund të njësive mësimore.^{xi}

Mesjeta në librat e viteve kur Maqedonia u bë shtet i pavarur

Republika e Maqedonisë, si ish-njësi federale e Jugosllavisë, pas shpalljes së pavarësisë (1991), u përpoq të ndërtoj si subjektivitetin politik, ashtu dhe identitetin historik të shtetit. Në këtë kuadër, ajo detyrimisht trashëgoi shumëçka nga shteti i përbashkët, përfshirë këtu edhe mënyrën e të shkruarit të përmbajtjeve mësimore të historisë. Në të vërtetë, në përputhje me rrethanat e reja, ku Republika e Maqedonisë që konceptuar si shtet etnocentrik, qenë hartuar edhe programet e reja, në bazë të të cilave u hartuan tekste përkatëse të historisë. Kështu, në librin “*Historia për vitin II gjimnaz (të përgjithshëm dhe gjuhësor)*”, botuar më 1992, për periudhën e mesjetës (shek. V-XV) janë hartuar tridhjetenëntë njësi mësimore, nga të cilat historia e përgjithshme dhe historia e Maqedonisë janë prezantuar me nga katërmëdhjetë njësi dhe ajo ballkanike me dhjetë njësi, dy prej të cilave janë për shqiptarët. Një njësi mësimore ndërlihet me sllavët e Ballkanit, përfshirë edhe ata në Maqedoni.^{xi} Me rastin e botimit II të plotësuar të këtij libri, më 1996, janë shtuar edhe dy njësi mësimore. Njëra ka të bëjë me historinë e popujve ballkanikë, kurse tjetra me shqiptarët. Në të vërtetë, sa u përket njësive për historinë e shqiptarëve, në vend të dy, tashti kishte tri njësi mësimore, dy prej të cilave trajtonin periudhën e mesjetës (shek. V-XV), kurse tjetra periudhën e shek. XVI-XVIII.^{xi}

Në njësi të caktuara mësimore të tekstit të sipërpërmendur bie në sy fakti se autori, duke dashur të ndërtoj identitetin historik të shtetit, është përpjekur të argumentojë vazhdimësinë e maqedonasve të lashtë në krijimin e etnisë sllavo-maqedonase. Në këtë kuadër ai thotë se maqedonasit e lashtë gradualisht ishin asimiluar nga popullata në numër më të madh sllave dhe nga përzjerja e tyre, në gjysmën e dytë të shek. X, ishte formuar populli i ri sllavo-maqedonas. Në të vërtetë, në kohën e sundimit të Samuil, sipas tij, ishte zhdukur copëtimi fisnor dhe fise të veçanta ishin shkrirë në një popull të vetëm. Madje, sipas tij, sllavët i kishin çliruar maqedonasit e lashtë nga skllavopronarët e tyre dhe i kishin shndërruar në njerëz të lirë.^{xi} Ngarkesa e këtij autori vjen në shprehje edhe si bie fjala për vendosjen e sllavëve në

territorin e sotëm të Shqipërisë, ku në një njësi mësimore thuhet se aty nga fundi i shek. VI dhe në fillim të shek. VII edhe territori shqiptar ishte populluar nga sllavët. Me këtë rast një numër i madh i popullsisë vendase (ilirë, grekë etj.) ishte vrarë ose ishte detyruar të shpërngulej në territoret e pa pushtuara bizantine. Sipas tij, nën pushtetin bizantin kishte mbetur gjoja vetëm Durrësi, ndërsa ata banorë vendas që nuk i kishin lëshuar vatrat e tyre u ishin nënshtruar udhëheqësve fisnorë sllavë ose ishin tërhequr në vise të thella malore. Më shumë se kaq, sipas këtij autori, nga vendasit e romanizuar dhe të helenizuar, përmes përzierjes me kolonistët sllavë dhe të tjerë, më vonë shkallë-shkallë ishte formuar populli shqiptar.^{xi} Në rrethana të kësilla, detyrimisht, për të argumentuar se “faktet” e prezantuara të autorit maqedonas janë të paqëndrueshme, do të radhisim argumentet përkatëse. Në këtë kuadër mund të përmendim faktin se çështja e origjinës dhe e fatit të maqedonasve të lashtë pas vdekjes së Aleksandrit të Madh (323 p. e. s.) është e diskutueshme.^{xi} Po ashtu është shumë e pasigurt çështja e vendosjes së fiseve sllave në territorin e Shqipërisë së sotme në shek. VI-VII dhe e raportit të tyre ndaj popullsisë iliro-arbërore. Në të vërtetë, burimet e kohës kanë regjistruar vetëm disa depërtime sporadike sllave në këtë territor dhe as që bëjnë fjalë për vendosjen e pushtetit përmes prijësve sllavë.^{xi} Pavarësisht kësaj, nuk përjashtohet mundësia që grupe të vogla sllave të jenë vendosur në territorin e Shqipërisë së sotme. Për vendosjen e një numri diç më të madh sllavësh mund të flitet posaçërisht pas pushtimeve bullgare, në shek. X,^{xi} sidomos në Shqipërinë Jugore. Por me rënien e Perandorisë Bullgare (1018) dhe me rivendosjen e pushtetit bizantin në Shqipëri, numri i sllavëve filloi të zvogëlohej.^{xi} Nga ana tjetër, formimi i etnosit arbëror ndoqi krejtësisht një rrugë tjetër nga ajo që e thotë më sipër autori maqedonas. Kjo provohet përmes “Kulturës së Komanit”, e cila është kultura e një populli që në shek. VI-VIII ishte në kapërcyell të dy epokave, nga ajo e vonë antike, në periudhën e hershme mesjetare. Kjo kulturë materiale i dallon në mënyrë të qartë bartësit e saj, arbit, nga fqinjët e tyre sllavë dhe grekë.^{xi}

Në funksion të mohimit të autoktonisë së shqiptarëve në viset e sotme të Republikës së Maqedonisë, në librin *“Historia për vitin II gjimnaz (të përgjithshëm dhe gjuhësor)”* (1992), kur flitet për fisnikun Andrea Gropa, i cili në një periudhë të caktuar të gjysmës së dytë të shek. XIV kishte ngritur një zotërim të pavarur feudal, në territorin që shtrihet që nga Ohri deri në Dibër, nuk thuhet se ai ishte arbër.^{xi}

Në aspektin gjuhësor, libri i sipërpërmendur i përkthyer nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe karakterizohet me shumë gabime drejtshkrimore, që e bënte atë të vështirë për t’u kuptuar nga nxënësit shqiptarë. Veç kësaj dukurie, në këtë tekst, vazhdoi të përdorej toponimia sllave,^{xi} që binte ndesh me rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe.

Libri i sipërpërmendur, botuar më 1992 dhe ribotuar më 1996 dhe 2001, sipas mendimit tonë, është shkruar me një stil të rëndë për moshën e nxënësve. Njësitë mësimore kryesisht janë voluminoze dhe përmbajnë shumë të dhëna, përfshirë këtu emra njerëzish e vendesh, data, ngjarje e rrethana të tjera. Përmbajtjet mësimore shoqërohen vetëm me ilustrime dhe pyetje e detyra.^{xi}

Në librin *“Historia për vitin I gjimnaz matematiko-natyror dhe profilin juridik”*, botuar më 1992, i hartuar sipas programit të shkurtuar, që përmban periudhat e antikës dhe të mesjetës (deri në

shek. XVIII), periudha e mesjetës që e trajtojmë ne (shek. V-XV) prezantohet përmes njëzeteshtatë njësisish mësimore. Nga ato, shtatë kishin të bënin me historinë e përgjithshme; tetë me historinë e popujve të Ballkanit, dy nga të cilat ishin për shqiptarët; dhe dhjetë njësi ishin për Maqedoninë. Një njësi mësimore ishte e përbashkët për sllavët e Ballkanit dhe të Maqedonisë, ndërsa tjetra për historinë e përgjithshme dhe për atë të Maqedonisë.^{xi}

Në aspektin didaktiko-metodik, libri i sipërpërmendur, me përjashtim të ilustrimeve, që janë më të pakta, është i ngjashëm me librin e vitit II gjimnaz i përgjithshëm dhe gjuhësor.

Demokratizimi i vazhdueshëm i jetës shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore në vend, në fillim të shek. XXI, ndikoi që tekstet e historisë të fillojnë të konceptohen sipas standardeve moderne metodologjike dhe didaktike. Në këtë drejtim, duke u mbështetur në programet e reja, u hodhën hapat e para drejt të shkruarit të teksteve të historisë me një gjuhë më të lehtë e më të kuptueshme për nxënësit. Njësitë mësimore filluan të shkarkohen nga informacionet e tepërta dhe u shkruan më të kompletuara për nga standardet didaktike-metodike. Nga ana tjetër, në aspektin e prezantimit të fakteve historike, respektivisht në zbatimin e standardeve shkencore-profesionale, nuk mundën të çlirohen deri në fund nga mbingarkesa e identitetit nacional, në veçanti njësitë që trajtojnë të kaluarën e popullit shumicë të Republikës së Maqedonisë. Për shkak të kësaj mbingarkese thuajse asgjë nuk lëvizti në paraqitjen sasiore dhe përmbajtjesore të njësive nga historia e popullit shqiptar për periudhën e mesjetës. Kjo më së mirë dëshmohej përmes librave të botuar gjatë viteve 2002-2003, përmbajtjet e të cilëve do të elaborohen më poshtë.

Mesjeta e hershme, në librin *“Historia për klasën I të shkollës së mesme”*, botuar më 2002, është prezantuar me dymbëdhjetë njësi mësimore. Nga ato, katër njësi janë nga historia e përgjithshme, një është për Ballkanin dhe gjashtë kanë të bëjnë me Maqedoninë. Një njësi tjetër mund të llogaritet si e përbashkët për Ballkanin dhe Maqedoninë.^{xi} Për shqiptarët ka vetëm një nën njësi *“Fiset shqiptare pas ardhjes së sllavëve”*, prej 11 vargjeve tekst të shkruar, e paraqitur në kuadër të njësive *“Krijimi i shteteve ballkanike”*.^{xi} Nga ana tjetër, në rrafshin didaktiko-metodik njësitë mësimore nuk janë voluminoze si në të kaluarën, respektivisht përmbajtja e tyre përputhet me moshën e nxënësve. Veç kësaj, përmbajtjet mësimore shoqërohen me një aparaturë të pasur didaktike, si ilustrime, pjesët *“mbani mend”* dhe pyetje dhe detyra.

Në librin *“Historia për vitin II të gjimnazit të reformuar”*, botuar më 2003, mesjeta e zhvilluar është trajtuar me gjithsej trembëdhjetë njësi mësimore. Në katër prej tyre është trajtuar historia e përgjithshme; në tri historia e Ballkanit, nga të cilat njëra është për shqiptarët; dhe në pesë historia e Maqedonisë. Një njësi mësimore me të dhënat e saj që ofron mund të konsiderohet si e përbashkët për historinë e Ballkanit dhe të Maqedonisë.^{xi} Në këtë tekst, ka prirje tendencioze, si bie fjala, kur thuhet se nën udhëheqjen e Skënderbeut kishin qenë pjesëmarrës në kryengritje një pjesë e madhe e maqedonasve nga rrethina e Dibrës, midis të cilëve ishte dalluar Moisi Golemi (Arianiti).^{xi} Në të vërtetë, e vërteta është krejtësisht ndryshe: familja fisnike e Arianitëve ishte me përkatësi etnike arbërore.^{xi}

Libri i sipërpërmendur, për nga mënyra e trajtimit të njësive mësimore, është i ngjashëm me atë të vitit I, botim i vitit 2002, por është më i avancuar për nga pasuria e ilustrimeve, si dhe

shtojcave “përkujtohu”, “gjurmë dhe kupto” dhe “nëse dëshiron të dish më tepër”.^{xi} Në të dy këto tekste ka një ndryshim cilësorë, meqë toponimet janë shkruar sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Mesjeta në librat aktual

Një ndryshim i rëndësishëm në Republikën e Maqedonisë u bë pas nënshkrimit të “Marrëveshjes Kornizë të Ohrit” (2001), sipas së cilës u bënë ndryshime në kushtetutë, me ç’rast u avancuan deri në një farë mase të drejtat e shqiptarëve. Mbi këto principe, u aprovuan edhe programet e reja mësimore të historisë, përfshirë këtu edhe atë për arsimin gjimnazor. Rrjedhimisht, në vitin 2006 u botuan tekstet e historisë për vitet I dhe II të arsimit gjimnazor, autorët e të cilëve janë maqedonas dhe shqiptarë.^{xi} Natyrisht se këto tekste shprehin një kompromis të arritur, gjë që më së miri shihet në formën e zbatimit të tyre në praktikë. Në këtë drejtim, në librin e viti I nga gjithsej 50 njësi mësimore, mësimdhënësit e historisë, në mënyrë të pavarur, duhet të realizojnë 38 prej tyre, kurse në librin e vitit II nga gjithsej 56 njësi, ata duhet të realizojnë 42. Kjo formë e përzgjedhjes, në fakt nuk e bën të zbatueshëm deri në fund tekstin për të gjithë nxënësit, sepse, sipas rrethanave që i njohim ne, pala maqedone e mësimdhënësve përcaktohet për realizimin e njërive mësimore vetëm nga historia e popullit maqedonas, kurse ajo shqiptare, krahas një pjese të njërive për historinë e popullit maqedonas, përcaktohet edhe për njësitë mësimore nga historia e popullit shqiptar. Pavarësisht këtyre lëshimeve, konsiderojmë se është bërë një hap përpara, ndërsa procesin e nisur duhet avancuar, në përputhje me zhvillimet pozitive që kultivohen në Republikën e Maqedonisë, shpeshherë të shoqëruara me mosbesim të ndërsjellë në rrafshin ndëretnik.

Historia e mesjetës së hershme, që trajtohet në librin “*Historia për vitin e parë (arsimi gjimnazor)*”, botuar më 2006 dhe ribotuar edhe dy herë të tjera (ne kemi përdorur botimin III të vitit 2009), duke pasur parasysh gjithnjë çështjen e “përzgjedhjes” që bëjnë mësimdhënësit, të elaboruar si më sipër, prezantohet me gjithsej nëntëmbëdhjetë njësi mësimore, nga të cilat në gjashtë trajtohet historia e përgjithshme; në katër historia e Ballkanit, nga të cilat dy janë për shqiptarët; dhe në nëntë historia e Maqedonisë.^{xi}

Në njësitë mësimore nga historia e përgjithshme që kanë të bëjnë me Bizantin, shetin frank, islamizmin dhe Rusinë e Kievit, me nga një nën njësi janë trajtuar kulturat e tyre. Pavarësisht kësaj, është hartuar edhe një njësi tjetër mësimore për mesjetën e hershme, në të cilën, përkundër faktit se nuk përsëriten njoftimet, trajtojnë kulturën e vendeve të përmendura. Në rrethana të këtilla, do të duhej që nën njësitë përkatëse të hiqeshin dhe të inkorporoheshin në njësinë përkatëse për kulturën e mesjetës së hershme. Një fenomen tjetër në këtë njësi mësimore është fakti se në nën njësinë Arabia dhe Rusia e Kievit trajtohet kultura e tyre,^{xi} gjë që është absurde, meqë këto dy vende nuk kishin asgjë të përbashkët.

Në njësitë mësimore ku trajtohet historia e mesjetës së përgjithshme hasen edhe një sërë lëshimesh shkencore, nga të cilat do të veçohen disa prej tyre, si më domethënëse. Kështu, kur bëhet fjalë për dyndjen e madhe të popujve gabimisht thuhet se ostrogotët, në vitin 375, pas konfliktit që kishin pasur me hunët, ishin drejtuar nga Ballkani dhe kishin hyrë në shërbim të

Perandorisë Romake.^{xi} Në të vërtetë fjala është për vizigotët, të cilët, në vitin 376, u lejuan të qëndronin në kuadër të zotërimeve romake, duke marrë përsipër të kryenin disa shërbime për perandorinë.^{xi} Për vizigotët gabimisht thuhet se pas vdekjes së Alarikut qenë drejtuar nga Spanja, duke themeluar atje shtetin e tyre.^{xi} Në fakt, vizigotët, fillimisht shtetin e tyre e themeluan në Francën Jugperëndimore, me qendër në Tuluz dhe me kalimin e kohës e shtrinë pushtetin e tyre edhe në gadishullin Iberik. Në fillim të shek. VI (507-510), si rrjedhojë e dobësimit të shtetit vizigot nga luftërat me shtetin frank, pushteti i vizigotëve u kufizua vetëm në Spanjë, me kryeqendër Toledon.^{xi} Një gabim i radhës në kuadër të së njëjtës njësie mësimore është ngjarja e vitit 476, ku thuhet se ostrogotët të udhëhequr nga Odoakri morën Romën.^{xi} Ky i fundit, në fakt, ishte me origjinë skire.^{xi}

Në njësinë mësimore për shtetin frank ka disa gabime, si p.sh. Klodoviku titullohet princ, kurse Karl Marteli mbret; Karli i Madh kishte luftuar kundër lombardëve, kurse Luigji i Devotshëm e kishte ndarë Perandorinë midis bijve të tij në tri mbretëri: Mbretëria Perëndimore Franke, Mbretëria Lindore Franke dhe Mbretëria Jugore Franke; vasalët mbretëror u kanë dhënë toka vasalëve të tyre, të quajtur seniorë.^{xi} Në të vërtetë realiteti është krejtësisht tjetër. Klodoviku është titulluar mbret, kurse Karl Marteli majordom; Karli i Madh kishte luftuar kundër longobardëve; ndarja përfundimtare e shtetit frank u bë sipas marrëveshjes së tre djemve të Luigjit të Devotshëm (843), të cilët e ndanë perandorinë në dy mbretëri dhe një perandori: Mbretëria Lindore i takoi Karlit, Mbretëria Perëndimore Ludovikut dhe pjesa qendrore (Perandoria), nga grykëderdhja e Renit deri në malet zvicerane, më tej Burgonja, Provansa, Langedoku, Lombardia deri në Italinë Qendrore, i takoi Lotarit, që mbante titullin perandor; seniorët ishin zotër të vasalëve, që iu ndanin toka.^{xi}

Në njësinë mbi paraqitjen dhe përhapjen e islamit ka disa lëshime serioze. Kështu, në hartën përkatëse të kësaj njësie është evidentuar Meka, por jo dhe Medina, ku ishte shpërngulur Muhameti. Njëherësh, hasen lëshime serioze edhe për sa u përket paraqitjes së fakteve historike. Rrjedhimisht, thuhet se aty nga mesi i shek VIII shteti arab që ndarë në dy pjesë: kalifati i Bagdadit dhe kalifati i Kordovës, dhe se ai i Bagdadit ekzistoi deri në shek. XI, kur u pushtua nga turqit selxhukë.^{xi} Në realitet, faktet flasin krejtësisht ndryshe. Aty nga gjysma e shek. VIII, në krye të shtetit arab u vu dinastia e re e Abasidëve, ndërsa njëri nga përfaqësuesit e dinastisë Emevije që u rrëzua nga froni, Abd el-Rahman, arriti të shpëtojë dhe më pas, në krye të një trupe të vogël ushtarake pushtoi Kordovën (756), duke themeluar emiratin e Andaluzisë. Më pas, më 929, emirati u transformua në kalifat. Ndërsa sa i përket kalifatit të Bagdadit, ai aty nga gjysma e shek. XI pësoi disfatë nga turqit selxhukë, ndërsa kalifi abasid El-Kaim (1031-1075) e njohu udhëheqësin e turqve, Tughril Beun, si “mbret”. Megjithatë, kalifati Abasid ekzistoi formalisht deri në vitin 1258.^{xi}

Në njësinë mësimore mbi Rusinë e Kievit po ashtu nuk prezantohen faktet ashtu siç janë. Aty midis të tjerave thuhet se në shek. IX princi Rurik i bashkoi fiset ruse veriore dhe krijoi principatën e Novgorodit. Fiset ruse jugore formuan principata në Smolensk dhe në Kiev. Princi Oleg ia bashkëngjiti principatës së Novgorodit principatën e Kievit, duke krijuar Rusinë e Kievit. Njëherësh, në shtojcën “Për kureshtarët”, midis të tjerave thuhet se emri i Rusisë rrjedh

nga fisi sllav i *rusëve*, të cilët jetonin në luginën e lumit Ros.^{xi} Nga ana tjetër, faktet flasin krejtësisht ndryshe. Princi Rurik që ishte pjesëtar i fisit *vareag* (fis normano-suedez), e pushtoi Novgorodin (862), ndërsa dy prijës të tjerë të tij pushtuan Kievin. Pas vdekjes së Rurikut, Olegu, tutor i djalit të Rurikut, Igor, e mori Kievin (882), që u bë kryeqendër e principatës së Kievit.^{xi} Fakti tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me emrin Rhos ose Rus, që në fakt nuk ishte emër i fiseve sllave, por kishte të bënte me një degëzim të vareagëve. Me fjalë të tjera emri në fjalë ishte me origjinë *fine* dhe nënkuptonte vareagët.^{xi}

Lëshime ka edhe në njësitë mësimore ku flitet edhe për vazhdimësinë iliro-arbërore, që dëshmohet përmes kulturës së Komanit. Me rastin e përmendjes së lokaliteteve ku është zbuluar kjo kulturë (Shqipëri, Kosovë dhe Korfuz), nuk përmenden vetëm lokalitetet që janë zbuluar në Maqedoninë e sotme Perëndimore,^{xi} pasi historiografia maqedonase nuk e pranon kontinuitetin iliro-arbëror në këto vise.^{xi} Në këtë rast do të kishim shtuar se prania e arbërve në Maqedoninë e sotme Perëndimore provohet edhe përmes burime të shkruara historike të shek. XIII dhe XIV^{xi} dhe defterëve osmanë të shek. XV.^{xi}

Në librin "*Historia për vitin e dytë (arsimi gjimnazor)*", botuar më 2006, mesjeta e zhvilluar (shek. XI-XV), gjithnjë duke pasur parasysh çështjen e "përzgjedhjes", është përfaqësuar me gjithsej tetëmbëdhjetë njësi mësimore, nga të cilat në pesë trajtohet historia e përgjithshme; në gjashtë historia e Ballkanit, nga të cilat pesë njësi janë për shqiptarët; në gjashtë historia e Maqedonisë, dhe një njësi mund të konsiderohet si e përbashkët për Ballkanin dhe Maqedoninë.^{xi}

Marrën në tërësi, në njësitë mësimore ku trajtohet periudha e shekujve XI-XV mund të evidentohen një sërë lëshimesh faktografike, por ne do të ndalemi në trajtimin e disave, që i kemi konsideruar si më domethënëse. Kështu, në njërën nga njësitë mësimore të historisë së përgjithshme thuhet se në shek. XII Bizanti kishte luftuar edhe kundër osmanëve,^{xi} që në fakt do të duhej të ishte kundër selxhukëve.^{xi} Po në të njëjtën njësi haset një lëshim edhe më i madh faktografik, kur thuhet se me rastin e pushtimit të Perandorisë Bizantine (1204), kryqtarët krijuan në territorin e kësaj perandorie shtetet latine, si: Perandorinë Latine, Perandorinë e Nikesë, Mbretërinë e Selanikut, despotatin e Epirit dhe disa principata në Greqi.^{xi} Nuk është vështirë të precizohet se nga këto shtete Perandoria e Nikesë dhe Despotati i Epirit ishin formacione shtetërore bizantine, që shpëtuan qytetërimin bizantin nga rënia,^{xi} duke u angazhuar për rimëkëmbjen e Perandorisë Bizantine. Lëshimi i radhës ka të bëjë me sulmin e turqve selxhukë ndaj kalifatit të Bagdadit, që vendoset në gjysmën e dytë të shek. XII, me ç'rast thuhet se kishin pranuar prej arabëve islamin.^{xi} Këto ngjarje, në fakt kishin ndodhur një shekull më parë, pas pushtimit të Bagdadit nga selxhukët (1055).^{xi}

Në njësitë mësimore ku trajtohet historia e popullit shqiptar, po ashtu ka lëshime faktografike që meritojnë vëmendje. Në këtë drejtim mund të përmendet fakti ku thuhet se pronat e mëdha feudale quheshin *dinate*,^{xi} që në të vërtetë ky term kishte të bënte me aristokratët (*dynatoi* = *të fuqishmit*).^{xi} Kur përshkruhet tërheqja e normanëve nga Arbëria, gabimisht thuhet se me këtë rast qe tërhequr edhe udhëheqësi i tyre Robert Guskardi, që në fakt është fjala për djalin e këtij të fundit - Boemundin.^{xi} Në një njësi tjetër, ku flitet për principatat shqiptare në shek. XIV, në

hartën e paraqitur nuk tregohet shtrirja e tyre territoriale,^{xi} ose së paku të shënoheshin orientimisht pa kufij familjet bujare shqiptare që qëndronin në krye të tyre.

Në vazhden e trajtimit të lëshimeve apo të keqinterpretimit të fakteve historike, do të kishim veçuar edhe një të dhënë, ku bëhet fjalë për rënien e Maqedonisë nën sundimin osman. Rrjedhimisht, thuhet se osmanët patën pushtuar qytetet e mbretit Marko, si Prilepin, Manastirin, Kratovën dhe Shkupin.^{xi} Po t'i referohemi literaturës relevante shkencore, atëherë del se kjo e dhënë nuk korrespondon me realitetin historik. Kështu, përgjithësisht dihet se në gjysmën e dytë të dekadës së tetë të shek. XIV, territoret e këtij feudali ishin ngushtuar bukur shumë, sa që nga qytetet e mëdha i kishte mbetur vetëm Prilepi. Përndryshe, Kratova kishte qenë në kuadër të zotërimeve të vëllezërve Dragash, kurse Shkupi nga viti 1377 deri më 1392, kur u pushtua nga osmanët, në kuadër të zotërimeve të Vuk Brankoviqit.^{xi}

Njësitë mësimore, si të historisë për vitin I,^{xi} ashtu dhe të historisë për vitin II, të arsimit gjimnazor,^{xi} kryesisht i përmbushin kriteret metodologjike dhe didaktike. Ato nuk janë shumë voluminoze dhe janë të pajisura me shumë ilustrime, harta, detyra, veprimtari kërkimore dhe projektuese. Mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk ka edhe përjashtime. Kështu për shembull në njërën nga njësitë mësimore ka pesë nën njësi, mbi pesëmbëdhjetë data, shumë emra dhe ngjarje.^{xi}

Përderisa librat e sipërpërmendur, përkundër lëshimeve të caktuara, i përmbushin deri në një farë mase standardet shkencore-profesionale, metodologjike dhe didaktike, kjo nuk mund të thuhet për librat e vitit I dhe II^{xi} të arsimit të mesëm profesional. Natyrisht, kjo është pasojë e asaj se këto libra janë përpiluar sipas programeve të vjetra, të cilat duhet ndryshuar sa më parë.

Në librin *"Historia për vitin I (arsimi i mesëm profesional)"*, botuar më 2010, trajtohet historia e përgjithshme, përfshirë këtu edhe periudhën e mesjetës (shek. V-XV), e cila prezantohet përmes nëntë njësisish mësimore dhe ajo e Ballkanit, me një njësi mësimore. Në kuadër të kësaj të fundit, bënë pjesë edhe një nën njësi e shkurtër për territorin e sotëm të Shqipërisë. Kur jemi te kjo nën njësi, duhet veçuar se mënyra e prezantimit të fakteve shkencore ka devijuar aq shumë sa që thuhet se një pjesë e fiseve sllave që ngulitur në territorin e sotëm të Shqipërisë, ku e gjetën popullsinë e lashtë të romanizuar, kryesisht ilire.^{xi} Në këtë rast duhet shtuar se jo të gjithë ilirët ishin romanizuar. Ata kishin mbijetuar, krahas kolonistëve romakë.^{xi}

Historia e Maqedonisë trajtohet në librin *"Historia e Maqedonisë për vitin II (arsimi i mesëm profesional)"*, botuar më 2010, ku zë vend edhe periudha e mesjetës "maqedonase". Kjo periudhë prezantohet përmes njëmbëdhjetë njësisish mësimore, ndërsa një nën njësi ka të bëjë me kryengritjen e Skënderbeut, por në kontekst të pjesëmarrjes së maqedonasve në kryengritje.^{xi} Kur jemi te ky libër, vlen të theksohet se në njërën nga njësitë mësimore të tij vazhdon të qëndrojë teza mbi origjinën e popullit maqedonas,^{xi} e paraqitur edhe në librin përkatës të historisë, që në vitet 90 të shek. XX, elaboruar nga ne me rastin e analizimit të atij libri.^{xi}

Marrë në tërësi, njësitë mësimore, si të historisë për vitin I,^{xi} ashtu dhe të historisë për vitin II, të arsimit të mesëm profesional,^{xi} i plotësojnë pjesërisht standardet didaktiko-metodike. Kur themi kështu mendojmë në atë se njësitë mësimore relativisht nuk janë shumë voluminoze dhe janë të pajisura me ilustrime, por jo edhe me tërë aparaturën e nevojshme didaktike. Rrjedhimisht,

duhet sa më parë të miratohen programet e reja, në bazë të të cilave do të hartoheshin tekste të reja, sipas standardeve më të avancuara, ku do të përpiloheshin edhe njësitë mësimore përkatëse për historinë e popullit shqiptar.

Përfundimi

Periodha e mesjetës në librat e historisë, botuar në vitin 1978, përfshirë këtu edhe atë shqiptare, prezantohej relativisht mirë në tekstet e historisë së arsimit të mesëm. Në aspektin didaktiko-metodik njësitë mësimore ishin voluminoze dhe të ngarkuara me shumë fakte. Përndryshe, ato deri diku ishin të pajisura me ilustrime të qarta, pyetje dhe detyra. Në një libër tjetër, hartuar sipas një programi të ri, të formës së shkurtuar (1989), mund të veçohet fakti se historia e popullit shqiptar prezantohej vetëm me një njësi mësimore. Në këtë libër që ndryshuar origjinaliteti i toponimeve, sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe, proces i përhapur në të gjitha sferat e jetës shoqërore e politike të vendit, si formë presioni ndaj “kombësisë” shqiptare në Republikën e Maqedonisë. Njësitë mësimore të këtij libri nuk ishin shumë voluminoze dhe një pjesë e tyre shoqëroheshin me pjesë leximi të karakterit burimor, si dhe me fjalorthin për termat e panjohura.

Pas pavarësimit të Maqedonisë, iu dha përparësi historisë së popullit maqedonas, përmes më shumë njësisë mësimore dhe nuk u lanë anësh as historia e përgjithshme e as ajo ballkanike. Historia e shqiptarëve prezantohej përmes 2-3 njësisë mësimore, ku në raste të caktuara kishte të dhëna të diskutueshme dhe të pa verifikuara në historiografi. Përndryshe, njësitë mësimore në tekstet e kësaj periudhe (vitet 90 të shek. XX) ishin në nivel të ulët metodologjik dhe didaktik. Hapat e parë për ndryshim e kësaj gjendjeje u bënë në fillim të shek XXI, kur u botuan tekste më të avancuara në përputhje me standardet bashkëkohore të përgatitjes së tyre. Megjithatë, në këto tekste, historia e shqiptarëve prezantohej në minimumin e mundshëm. Kjo situatë u ndryshua, me rastin e botimeve të teksteve të historisë për arsim gjimnazor, më 2006, kur u rrit ndjeshëm numri i njësisë mësimore për historinë e popullit shqiptar. Në këto njësi, si dhe në njësitë e tjera ku trajtohet historia e përgjithshme, ajo ballkanike dhe e Maqedonisë janë bërë një sërë lëshimesh faktografike, që duhet evituar. Pavarësisht kësaj, njësitë mësimore të mesjetës, në këta libra, kryesisht i përmbushin kriteret metodologjike dhe didaktike. Ato nuk janë shumë voluminoze dhe janë të pajisura me shumë ilustrime, harta, detyra, veprimtari kërkimore dhe projektuese. Nga ana tjetër, kanë mbetur të vjetruar librat e historisë së arsimit të mesëm profesional, botuar më 2010, të cilët ngecin si në aspektin metodologjik, ashtu edhe në atë përmbajtësor. Rrjedhimisht, ata duhet zëvendësuar me libra të rinj bashkëkohorë, të cilët do hartoheshin sipas programeve të reja mësimore, ku do të përfshiheshin edhe një numër i konsiderueshëm njësisë mësimore për historinë e shqiptarëve.

Bibliografia

Anamali Skender, *Nga ilirët tek arbërit (shqiptarët e hershëm)*, në: “Shqiptarët dhe trojet e tyre”, Tiranë, 1982.

Boshkoski Millan etj., *Historia për vitin e parë (arsimi gjimnazor)*, Shkup, 2009.

Boshkoski Millan etj., *Historia për vitin e dytë (arsimi gjimnazor)*, Shkup, 2006.

Boshkoviq Miroslav - Maçevska Dançe, *Historia për vitin I (arsimi i mesëm profesional)*, Shkup, 2010.

Boshkoviq Miroslav - Maçevska Dançe, *Historia e Maqedonisë për vitin II (arsimi i mesëm profesional)*, Shkup, 2010.

Божич Иван, *Албанија и Арбанаси у XIII, XIV и XV веку*, në: “Глас” САНУ (одељење историјских наука), CCCXXXVIII/3, Београд, 1983.

Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë (shek. X-XV), përgatitur për botim nga Koço Bozhori - Filip Liço, Tiranë, 1975.

Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, II, përgatitur për botim nga Aleks Buda etj., Tiranë, 1962.

Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë – Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, vëll. I, përgatitur për botim nga Frano Prendi etj., Tiranë, 1965.

Dalipi Qerim, *Rënia e Maqedonisë së sotme Perëndimore nën sundimin osman*, në: “Studime albanologjike”, nr. 1, Shkup, 2009.

Dinev Risto etj., *Historia për klasën II të shkollave të mesme (për gjimnaze)*, Shkup, 1978.

Документи за борбата на македонскиот народ за самостојност и за национална држава, том први, редакција Христо А. Полјански etj., Скопје, 1981.

Ducellier Allain, *L'Arbanon et les Albanaïs au XI^e siècle*, në: “L'Albanie entre Byzance et Venise, X^e-XV siècles”, London, 1987.

Ферлуга Јадран, *Драч и негово област од VII до почеток XIII века*, në: “Глас” САНУ (одељење историјских наука), CCCXLIII/5, Београд, 1986.

Грозданова Б. Вера, *Споменици од хеленистичкиот период во СР Македонија*, Скопје, 1987.

Gjyzelev Bojan, *Shqiptarët në Ballkanin Lindor*, Tiranë, 2005.

Historia e popullit shqiptar, I, Prishtinë, 1979.

Historia e popullit shqiptar, I, Tiranë, 2002.

Историја на македонскиот народ, том први, Скопје, 2000.

Историја српског народа, друга књига, Београд, 1994.

Јиречек Константин, *Трговачки путеви и рудници Србије и Босне у средњем вијеку*, në: “Зборник Константина Јиречека”, I, уредник Михајло Динић, Београд, 1959.

Kartov Vladimir etj., *Historia për vitin I për të gjitha drejtimit, përveç drejtimit kulturologjiko-arsimor dhe administrativo-juridik*, Skopje, 1989.

Korkuti Muzafer, *Parailirët, ilirët, arbërit (histori e shkurtër)*, Tiranë, 2003.

Kushevski Vojo etj., *Historia për klasën I të shkollave të mesme (për gjimnaze)*, Shkup, 1978.

Македонска енциклопедија, I, Скопје, 2009.

Murzaku Thoma etj., *Historia e mesjetës (shek. V-XIII)*, Tiranë, 2003.

Одбрани текстови за историјата на македонскиот народ, I дел, составил Љубен Лапе, Скопје, 1975.

Ostrogorski Georg, *Historia e Perandorisë Bizantine*, Tiranë, 1997.

Панов Бранко етј., *Историја за I клас природно-математичка гимназија и правна струка*, Скопје, 1992.

Панов Бранко етј., *Историја за II клас гимназија (општа и јазична)*, Скопје, 1992.

Panov Branko етј., *Historia për vitin II gjimnaz (të përgjithshëm dhe gjuhësor)*, Shkup, 1996.

Папазоглу Фанула, *Илирска и дарданска кралевина*, нѐ: "Илири и Албанци", САНУ (одељење историјских наука), XXXIX, 10, Београд, 1988.

Pavllovski Gjorgji етј., *Historia për vitin II të gjimnazit të reformuar*, Shkup, 2003.

Поповић Владислав, *Албанија у касној антици*, нѐ: "Илири и Албанци", САНУ (одељење историјских наука), XXXIX, 10, Београд, 1988.

Ростовцев Михаил, *Историја старог света – Грчка и Рим*, Нови Сад, 1990.

Sherif Ahmet, *Historia për klasën I të shkollës së mesme*, Shkup, 2002.

Турски документи за историјата на македонскиот народ – Опширен пописен дефтер по. 4 (1467-1468 година), под редакција на Методија Соколоски – Александар Стојановски, Скопје, 1971.

Удаљцов - Космински - Ванштајн, *Историја средњег века*, I, Приређено према штампаном издању из 1950. године, обрада и кориговање текста О. Ш., osekulj@ya.ru (botim elektronik në formatin PDF).

Византиски извори за историју народа Југославије, том I, обрадили: Фрањо Баришић етј., Београд, 1955.

Vojna enciklopedija, 8, Beograd, 1966.

Xhufi Pëllumb, *Dilemat e Arbërit - Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, Tiranë, 2006.

Xhufi Pëllumb, *Zotërimi i Gropave të Dibrës në shek. XIII-XIV*, нѐ: "Dibra dhe etnokultura e saj", I, Dibër, 1995.

Законски споменици српских држава средњег века, прикупио и уредио Стојан Новаковић, Београд, 1912.